



Ulvi Fejzullahu

Gjatë ditës nuk pata kohë të shfletoja lajmet ditore, por dikur pas namazit të jacisë fillova të shohë se çka ka bërë vaki! Kur pa prit e pa kujtuar u ndesha me “zërin” (<http://www.zeri.info/artikulli/17856/hoxhallare-para-historik-video>) me një titull vërtetë parahistorik: “Hoxhallarë para-historik”. Me vete thashë, hajmedet çka pas ka “shkretu” Enis Rama.

Lexova shkrimin e gazetarit, pastaj, dëgjova nga kureshtja videon në fjalë. Aty për aty thashë qenka e kundërta, pasmi të bëjmë me gazetarë para-historik.

Të nderuar imanli!

Unë kam vendosur që “Zërit” tua dërgoj një mirënjohje dhe falënderim special.(Ju lutem mos më paragjykoni, këtë njëmend e kamë.) Kësaj gazete dhe gazetarëve të sajë, ja vlen një përshëndetje për mënyrën që kanë zgjedhur për ta fyer Islamin dhe myslimanët duke i etiketuar hoxhallarët. Ata më këso veprimesh, vërtetë po i shërbejnë Islamit.

Unë, personalisht nuk pres prej këtyre që të ndajnë një hapësirë për temat Islame. Ata këtë nuk e bëjnë dhe nuk lejojnë. Por, mjafton që të kundërtën që po e bëjnë. Padyshim që edhe kjo është e shëndetshme. Këto sjellje dhe veprime të gazetarëve po ndikojnë duke tërhequr vëmendjen edhe të atyre që nuk janë të njohur me Islamin.

“Gazetarë para-historik” e jo “Hoxhallarë para-historik”!

Krijuar: Merkure, 16 Tetor 2013 22:18

Padyshim që kemi njerëz racional dhe më nuk po dëshirojnë të jetojnë në ndikimin e gazetave dhe gazetarëve para-historike. Në momentin kur po njihen me të vërtetën, po e përqafojnë.

Kush e ka bërë mend, që gazetat me shkrime antislame janë sebeb për t'u shtrirë e vërteta Islame edhe tek xhematet e saja.

Për këtë duhet falënderuar Allahun e Lartësuar. Dhe mirënjohje të veçantë për “zërin”.

Ju lutem, herë pas here vazhdoni të bëni këso veprime, se janë të shëndetshme, edhe pse ju e mendoni të kundërtën.